



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë **23.11.2022**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 22.11.2022, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik N. SH. Ambulanca Veterinare „ INDRITI; Ambulanca Dhe Farmacia Veterinare Goni, enver topalli, 70000, Ferizaj, Kosovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Trajtimi i qenëve endacak”** me Nr. të Prok: 613 022 111 236.

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e **Grupit të Operatorëve Ekonomik N. SH. Ambulanca Veterinare „ INDRITI; Ambulanca Dhe Farmacia Veterinare Goni, enver topalli, 70000, Ferizaj, Kosovë** të dt. 22.11.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Trajtimi i qenëve endacak”**, me nr. të Prok: **613-22-111-236**.

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për **o.e Veterina 1 shpk Prishtine**, i datës 21.11.2022, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Mbetet në fuqi** Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 21.11.2022.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Ar sy e t i m

Grupi i Operatorëve Ekonomik N. SH. Ambulanca Veterinare „ INDRITI;
Ambulanca Dhe Farmacia Veterinare Goni, enver topalli, 70000, Ferizaj, Kosovë, me datë 22.11.2022, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Trajtimi i qenëve endacak**” me nr. të Prok: **613-22-111-236**, ku në këtë aktivitet AK ka shperblyer me kontrate **o.e Veterina 1 shpk Prishtine**, me date: 21.11.2022, të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Grupi i Operatorëve Ekonomik N. SH. Ambulanca Veterinare „ INDRITI;
Ambulanca Dhe Farmacia Veterinare Goni, enver topalli, 70000, Ferizaj, Kosovë, me datë. 22.11.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Trajtimi i qenëve endacak**” Autoriteti Kontraktues, me datë 23.11.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues, gjatë vleresimit të ofertes tuaj ka konstatuar që juve ju mungon:

I. Një eskavator

Komisioni per vlersim te ofertave ka vlersuar lenden sipas ligjeve te LPP-se dhe Bazuar në Legjislacionin ne fuqi, me date 31.10.2022 kemi kerkuar sqarime shtese per “Paisjet dhe mekanizmi i obligueshem sipas tabelës ne Aneksin 6 te DT siq jane: 1.Eskavator dhe 2. Pikap

Me date: 02.11.2022 kemi marre pergjigjjen per letren sqaruese ku eshte ngarkuar Kontrata per groposjen e qenve e lidhur me 09 tetor 2019 ne mes te Avni Nuhaj B.I dhe Agron Pajaziti B.I, ku lenda e kesaj kontrate eshte “Groposja dhe mbulimi me dhe te qeneve” ku sherbimi do te kryhet ne baze te kerkeses se Drejtorise se Bujqesise se Komunes se Ferizaj, qe nenkupton se kjo kontrate nuk ka asgje te beje me Komunen e Lipjanit.

Ky Pretendim i juaji per ne si AK eshte i Pa Bazuar

AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani


Drejtör i Prokurimit